



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS AUTORITY FOR COMPETITION KOSOVO COMPETITION AUTHORITY	
Nr. Prot. nr. Proq-Prot. No.	111/19 - 02/10
Nr. Fc. Bc. S. Pk. Pg.	1/4
Data/Bashm/Date	25.04.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi nr.17/19
Data: 25.04.2019

Duke u bazuar në Neni 28, 29 dhe çështjet procedurale, të përcaktuara sipas nenit 15,17,19,20,35,50,54 paragrafi 1.3 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe Plotësim Ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarjeve, Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës 25.04.2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET**, Përqendrimi përmes përfitimit 100% të kontrollit nga Coca-Cola HBC-Serbi Industria e pijeve alkoolike d.o.o. Beograd, kompani me përgjegjësi të kufizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Serbisë, e cila e ka selinë e regjistruar në Batajnički drum 14-16, 11080 Beograd, me numër të regjistrimit 07462905, **Mbi Bambi a.d.** Koncern për Prodhimin dhe Shitjen e Ëmbëlsirave, kompani aksionare jopublike e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Serbisë me seli të regjistruar në Dure Đakovića bb, në Požarevac me numër të regjistrimit 07162936.
- II. **Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3.000.00 € me shkronja (tre mijë euro).
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni

ARSYETIM

Me datë 08.03.2019 Autoriteti ka pranuar kërkesën e Njoftimit për Përqendrim nga Coca-Cola HBC, Industria e Pijeve Joalkoolike, d.o.o., Beograd - Serbi, mbi Bambi a.d., Koncern për Prodhimin dhe Shitjen e Produkteve Konditorike/Ëmbëlsirave, Požarevac-Serbi. Kërkesa është paraqitur në bazë të Ligjit Nr.03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji Nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve.

Procedurat e ndjekura nga Autoriteti :

1. Njoftimi i përqendrimit në Web Faqen e Autoritetit me dt.12.03.2019 ;
2. Vërtetimi, me të cilin Autoriteti ka konsideruar lëndën të plotësuar me dt. 25.03.2019 .
3. Autoriteti ka bërë vlerësimin e qëllimit të realizimit të Përqendrimit sipas procedurës së shkurtër.

Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me:

Përqendrimin ("Transaksioni") i cili ka të bëjë me fitimin e kontrollit të plotë, nga Coca-Cola Hellenic Bottling Company-Srbija, Industria e pijeve joalkoolike d.o.o. Beograd, kompani me përgjegjësi të kufizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Serbisë, e cila e ka selinë e regjistruar në Batajnički drum 14-16, 11080 Beograd, me numër të regjistrimit 07462905 ("Coca-Cola HBC-Srbija" ose "Blerësi")

Coca-Cola HBC, merret me mbushjen e Coca – Cola. Coca-Cola HBC ofron një gamë të larmishme të pijeve freskuese të gatshme, kryesisht joalkoolike në kategorinë e pijeve të gazuara, lëngjeve, ujit, pijeve sportive – energjike, çajit dhe kafesë. Biznesi primar i Coca-Cola HBC Kosovo SHPK është: prodhimi i pijeve joalkoolike, prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe.

Coca-Cola HBC, ka një filiale të regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës e identifikuar si Coca-Cola HBC Kosovo SHPK, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë ("ARBK") me numër të biznesit 70007149 dhe me seli në "Kilometrin e pestë",Rr.Prishtinë-Shkup në pronësi të CC Beverages Holdings II B.V. me një kapital të paguar prej 5,000.00 EUR.

Të hyrat e përgjithshme lokale të Coca-Cola HBC-Kosovë, për vitin 2017 janë 52,050,875 EUR.

Mbi Konzern za proizvodnju i promet konditorskih proizvoda Bambi a.d. Požarevac, kompani aksionare jopublike e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Serbisë me seli të regjistruar Đure Đakovića bb, në Požarevac me numër identifikues 07162936 ("Bambi a.d." ose "Shoqëria Target") dhe që e ka pronar të vetëm të saj Danube Foods Group B.V., kompani e korporatizuar në Holandë, me seli të regjistruar në Prins Bernhardplein 200, 1097JB Amsterdam, me numër të regjistrimit 34180508 ("Shitësi");(Coca-Cola HBC-Srbija dhe Bambi a.d. .

Bambi a.d., i cili është biznes kryesor rajonal i ëmbëlsirave. Kompania prodhon një varg produktesh përfshirë biskotat, vaferët dhe ushqimet e lehta pikante. Në vitin 2018, Bambi regjistroi të hyra prej afërsisht 90 milionë euro në tërë botën, prej të cilave mbi dy të tretat u gjeneruan në Serbi. Brendet e kompanisë përfshijnë Plazma,Wellnes,Zlatni Pek,biskotat Bambi,Josh etj.

Bambi a.d. nuk ka të regjistruar asnjë filialë në Republikën e Kosovës, por e zhvillon biznesin e saj përmes distributorit të saj "Elkos SH.P.K", një kompani me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës në ARBK me numër të biznesit 70142364 me seli në Rr." Nexhdet Basha "2, Pejë në pronësi të Z. Ramiz Kelmendi me një kapital prej 30,000,000.00 EUR. Në vitin 2018, Bambi a.d., përmes distributorit të vetë Elkos SH.P.K ka realizuar të hyra të përgjithshme lokale në shumën prej 4,474,858 EUR.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

- Bazuar në nenin 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, palët kanë përmbushur detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:
 - a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, kalon shumën 20 milion EURO
 - b) Blerësi është i regjistruar në Republikën e Kosovës.
 - c) Kontrata e Shitblerjes, datë 17.02.2019.

Analiza e Tregut

Tregu Relevant

- Pasi që, blerësi është i regjistruar në Kosovë, **Tregu gjeografik** në transaksionin e propozuar do të jetë territori i Republikës së Kosovës, Ballkani perëndimor, respektivisht tregu Evropian.

Ndërsa

- **Tregu i produktit**, përfshin prodhimin dhe shitjen me shumicë të produkteve konditorike/ëmbëlsirave.

Pjesët e tregut dhe nivelet e përqendrimit

Përqendrimet jo-horizontale, nuk përbëjnë një kërcënim për konkurrencën efektive, vetëm nëse njëësia e përqendruar ka një shkallë të konsiderueshme të fuqisë në treg, në të paktën një nga tregjet përkatëse, por kjo nuk do të thotë se njëësia e përqendruar duhet të ketë pozitive dominuese të produkteve konditorike /ëprodukteve konditorike /ëmbëlsirave .

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Përqendrimi është propozuar në Serbi, por kërkesa për njoftim të përqendrimit është hënë për arsye se blerësi ka degën e saj të regjistruar në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara vërejmë se targeti Bambi a.d. nuk ka degë të regjistruar në tregun e Republikës së Kosovës, por vepron përmes distributorit të saj dhe si i tillë nuk ka mundësi të bëhet ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale) të tregut, andaj vlerësojmë se është transaksion konglomerat. Autoriteti vlerëson se ky përqendrim nuk ka mbivendosje horizontale ose efekte vertikale sepse ndërmarrjet operojnë në dy tregje të ndryshme, përqendrim i dy kompanive në industri të ndryshme .

Autoriteti shqyrtoi dhe arriti në përfundimin se nuk ka efekte negative nga realizimi i këtij përqendrimi sepse asnjëri nga pjesëmarrësit në përqendrim nuk vepron në tregun e njëjtë relevant dhe në mes tyre nuk ka marrëveshje horizontale, njëdhimisht asnjëri nga pjesëmarrësit nuk vepron në tregun në të cilin rënjët dhe ngritjet, në raport me tregun në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër i përqendrimit nuk ka lidhje vertikale dhe transaksioni nuk do të ketë efekt në konkurrencë, në Republikën e Kosovës.

Vëmendje


Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën **monitorimin** e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.


Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**



Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar



Fatime Haziri
Komisionere



Muhamed Krasniqi
Komisioner



Shaqir Morina
Komisioner